



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 573/1 Prot.
2024

Tiranë, më 24 . 04 .

V E N D I M

Nr. 108, datë 24 . 04 . 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 77 Regj., datë 11.04.2024, të shtetas M. Y, kundër Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, shtetasja M. Y, në shpjegimet e paraqitura para Komisionerit, është shprehur se, problematika e saj konsiston si më poshtë citohet:

“Unë shtetasja M. Y, nëpunës civil prej vitit 2020, me detyrë “Specialist” pa grada/tituj, në Sektorin e Menaxhimit të Resurseve dhe Shtimit të Materialit Mbjellës Bimor, në Drejtorinë e Teknologjive të Pemëtarisë, në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Vlorë, kategoria IV-a, saktësisht punonjëse në Laboratorin e Biologjisë Molekulare dhe Fiziko-Kimik, nuk e përfitoj pagesën e vështirësisë në punë, bazuar në VKM nr. 321, datë 31.05.2023.

Me datë 19.03.2024, kam dërguar një e-mail sqarues tek specialistët e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), mbi pozicionin tim dhe arsyet e detajuara se përse duhet ta përfitoj pagesën dhe kushtet aktuale të laboratorit ku unë punoj.

Përgjigjja ka ardhur elektronikisht, me datë 26.03.2024, nga znj. Z. J, përfaqësuese e Ministrisë, duke më deklaruar se nuk e përfitoj pagesën në bazë të VKM-së lartpërmendur, pa më dhënë arsyet përkatëse.”

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

Ankuesja shprehet se nuk ë përfiton pagesën e vështirësisë edhe pse punon në kushte që mbartin rrezikshmëri për shëndetin, duke cituar se, dhe ambienti i punës mbart në vetvete rrezikshmëri të lartë për shkak të kontaktit me kimikate të rrezikshme, apo për shkak të reagentëve me të cilët punon, duke i cilësuar një pjesë të tyre si kancerogjenë dhe mutagjen të mundshëm. Po ashtu, ankuesja është shprehur se herë pas herë ekspozohet edhe ndaj rrezatimit ultravjollcë, për shkak të pajisjeve të punës me të cilat punon, ekspozim i cili në mënyrë të përsëritur dhe në kushtet e mungesës së masave shtesë, përbën rrezik për dëmtime akute apo afatgjata në shëndet.

Në përfundim, subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri shprehimisht: *“Ju lutem më informoni nëse legjislacioni shqiptar aktual ma njeh të drejtën e marrjes së pagesës për vështirësinë/rrezikshmërinë në punë dhe cilët hapa duhet të ndjek për të kërkuar të drejtën time.”*

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, dhe për këtë arsye, nëpërmjet e-mail-it datë 11.04.2024, KMD, i ka kërkuar subjektit ankues të plotësojë atë².

Në përgjigje të kërkesës të mësipërme, ankuesja nëpërmjet e-mailit datë 15.04.2024, ka dërguar parashtrime shtesë³, si më poshtë vijon:

“Pasi më është refuzuar në mënyrë të pashpjeguar e drejta për t’u përfshirë në kategorinë e punonjësve që marrin shpërblimin e dëmshmërisë në punë, në bazë të një VKM të cituar, jam njohur me vendimin e Këshillit të Ministrave me Nr. 326, datë 31.05.2023, për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike. Në këtë vendim përmendet se, përveç punonjësve të shërbimeve mbështetëse, edhe punonjësit e specialiteteve të tjera të administratës shtetërore, në varësi të ministrive apo rajonale (pika 1a dhe 1b) kanë të drejtën e përfitimit. Mendoj që përjashtimi im nga kjo e drejtë ligjore është i qëllimshëm dhe diskriminues, që besoj lidhet me pozicionin tim të punës si specialist. VKM në fjalë nuk u referohet vetëm punonjësve të shërbimeve mbështetëse por edhe atyre të specialiteteve të tjera (ku mendoj se përfshihem). Me përgjigjen e dhënë dhe veprimet e kryera, (ku refuzohej hapur mundësia që unë të përfitoja pagesën por edhe mungesa e kontrollit të laboratorit për të parë shkallën e rrezikshmërisë), mendoj që janë përzgjedhur pozicione specifike pune, për shkak të natyrës së

² Citojmë shprehimisht: *“Lidhur me provueshmërinë për shkakun e pretenduar “çdo shkak tjetër”.Lista e shkaqeve të parashikuara në LMD (Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, te ndryshuar) është një liste e hapur shkaqesh, ku çdo shkak tjetër, në vetvete nuk është shkak sipas percaktimeve të LMD-se, pasi duhet të jetë i lidhur me një cilesi a karakteristikë të veçantë tuajën. Komisioneri vëren se, “viktimat” e diskriminimit e kanë detyrimin të paraqesin fakte dhe prova nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim apo mbi bazën e të cilave të bëjnë të besueshëm pohimin se është bërë diskriminim. Pastaj, barra e provës i bartet të paditurit, i cili gjatë zhvillimit të procedurës hetimore duhet të dëshmojë se nuk ka pasur diskriminim, apo se ka pasur arsye ligjore për trajtim të pabarabartë. Komisioneri vlerëson se, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë. Në këtë kontekst, ju lutem të provoni dhe dokumentoni shkakun e pretenduar prej jush si “ çdo shkak tjetër”; lidhjen e këtij shkakun me trajtimin, si dhe ju lutem, të indentifikoni qartazi subjektin kundër të cilit ju pretendoni diskriminimin. Në përfundim, cilat janë masat e kërkuara prej jush, nga KMD.”*

³ Sqarim në lidhje me ankesën e bërë me nr. 77 regj., në datë 11.04.2024, te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

tyre. Qëllimisht po anashkalohej pagesa për pozicionin tim si specialist në laborator (apo edhe laborante që e kryej realisht), ndërkohë që sipas VKM Nr. 326 jam e përfshirë në dy kategori rreziku (lidhja 3, pika 1d dhe 2b); kategoria e parë ku rrezikohem nga rrezatimi ultravjollcë (punoj me disa aparatura që në bazë të punës së tyre kanë këtë lloj rrezatimi, si transiluminator, kapa e PCR) dhe përfshihem në kategorinë e dytë për rrezikun nga substancat kimike që hyjnë në organizëm dhe janë toksike.

Duke marrë parasysh që pozicioni im i punës përmbush/plotëson 2 shkallë të rrezikshmërisë, bazuar në VKM e cituar më lart, mendoj se jam e përjashtuar pa të drejtë nga përfitimi i pagesës sipas ligjit.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë me të cilët kam komunikuar, janë treguar diferencues kur më kanë mohuar të drejtën, me argumentin që kjo pagesë merret vetëm për shërbimet mbështetëse, sipas VKM që ato kanë cituar. Mendoj që me këtë sjellje diskriminuese, tentohet të shpërblehen pozicione specifike pune dhe jo pozicioni im që jam realisht e rrezikuar dhe që përmbush kushtet ligjore për ta marrë këtë pagesë. Përveç faktit që kam punuar në kushte jo të favorshme pune duke rrezikuar shëndetin, edhe pas miratimit të VKM mbi këtë tematikë, kjo e drejtë po me mohohet.

Autoriteti përgjegjës për këtë diskriminim është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (nisur nga përgjigja e tyre)

Kërkoj nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të verifikojë të drejtën time ligjore nëse jam ose jo përfituese e pagesës së dëmshmërisë në punë, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave të datës 31 Maj 2023 dhe ndaj meje të zbatohen detyrimet ligjore që rrjedhin nga zbatimi i kësaj VKM. Gjithashtu, cilat janë masat/veprimet ligjore që duhet të ndërmmarr, që kjo e drejtë të vihet në zbatim dhe të mos më cënohet shëndeti gjatë punës.”

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare_ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Nga këqyrja e analizimi i parashtrimeve dhe dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, rezulton se:

- Sipas shkresës me nr. 3779 prot., datë 20.08.2020, të Departamentit të Administratës publike (në vijim referuar si DAP-i), znj. M. Y është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist”, pa grada/tituj, në Sektorin e Menaxhimit të Resurseve dhe Shtimit të Materialit Mbjellës Bimor, në Drejtorinë e Teknologjive të Pemëtarisë, në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Vlorë, kategoria IV-a.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 4509/1 prot., datë 16.08.2022, “Akti i Deklarimit të statusit të Nëpunësit Civil në përfundim të periudhës së provës”, DAP-i, në përfundim të periudhës së provës, ka deklaruar znj. M. Y nëpunës civil në pozicionin “Specialist”, pa grada/tituj, në Sektorin e Menaxhimit të Resurseve dhe Shtimit të Materialit Mbjellës Bimor, në Drejtorinë e Teknologjive të Pemëtarisë, në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Vlorë, kategoria IV-a.
- Ankuesja (në emrin e saj dhe të koleges E. P) nëpërmjet e-mailit datë 19.03.2024, i është drejtuar strukturave të MBZHR-së⁴, duke kërkuar nga ana tyre një sugjerim lidhur me kërkesën bashkëlidhur e-mailit. Në përmbajtje të kërkesës së tyre⁵, ndër të tjera, citohet si vijon:

“Do të donim një konsulencë nga ana juaj për një shqetësim tonin që lidhet me rrezikshmërinë e shëndetit, kushtet e punës dhe profesionin që ushtrojmë.

Jemi dy biologe që punojmë në laboratorët e Qendrës ë Transferimit të Teknologjive Bujqësore (TTB) Vlorë.

Edhe pse me profesion jemi biologe, ne nuk kemi staf teknik laborator/laborant dhe të gjithë proceset e punëve teknike në laborator i kryejmë vetë, deri dhe pastrimin e larjen e enëve laboratorike.

M. Y- Jam biologe, Specilaiste, pa grada e tituj, me 5 (pesë) vjet punë në laborator.

Punoj në:

⁴ Specialistes E. V, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse/MBZHR.

⁵ Më lëndë: “Kërkesë për informacion”

A) Laboratorin Biokimik, për analizat fiziko-kimike gjithëpërfshirëse të vajit të ullirit, të frutave të kultivarëve drufrutore bërthamore, të kultivarëve të agrumeve, të kultivarëve të hardhisë.

Rrezikshmëria në Laborator: Laboratori nuk ka kushte sigurie dhe aparatura që minimizojnë riskun dhe kontaktin tim me kimikatet e dëmshme (gjatë analizave të vajit) deri edhe duke pamundësuar kryerjen e analizave. Ajrimi mungon dhe bëhet e vështirë puna, pa pasur siguri për shëndetin.

B) Laboratorin e Biologjise molekulare për analizat gjenetike dhe indentifikim molekular të kulturave drufrutore. Në këtë laborator kryhen analiza të identifikimit gjenetik dhe të diagnostikës molekulare.

Rrezikshmëria në ambientin e punës: Në laborator mungon sistemi i ajrimit dhe pajisja e kapës kimike për uljen e rrezikut të ndotjes, nga prania e kimikateve të rrezikse që unë punoj, gjatë ekstraktiveve me solvent organik të ADN dhe ARN/ proteinave. Disa nga substancat kimike me të cilat punoj rregullisht përfshijnë: PVP, βmerkaptoetanol, kloroform, izoamilalkol, isopropanol, fenol i acidifikuar, reagent trizol, klorur litiumi, guanidium tiocianat, bromur etidiumi, methanol, eter dietilik, acid sulfurik, azot i lëngshëm, DMSO etj, një pjese e mirë e të cilëve janë karcenogjen/mutagjen të mundshëm dhe potencialisht të rrezikshëm. Duke pasur mungesa të theksuara në infrastrukturën laboratorike puna me këto reagent bëhet jo vetëm e vështirë por e rrezikshme për shëndetin dhe ekspozimi i vazhdueshëm ndaj këtyre agjentëve rrit mundësinë e dëmeve afatgjata dhe akute në shëndetin tim. Ekspozimi i përditshëm ndaj rrezeve UV (nga puna me transiluminatorin) rrit rrezikun për dëmtim të syve dhe lëkurës, duke qënë se ne laboratorin e biologjisë molekulare në QTTB Vlorë nuk ka një pajisje të mirëfilltë që ta minimizojë dëmin dhe ekspozimin ndaj rrezatimit.

.....

Nuk disponojme sisteme ventilimi dhe kondicioner në ambientet e punës në laborator.

Pyetja qe ne kemi është nëse mund të perfitojmë pagesën e vështirësisë në punë, për këtë nivel rrezikshmërie në shëndet? Cilat hapa na këshilloni që të ndjekim më tej?”

- Në përgjigje të sa më sipër, ankuesja nëpërmjet e-mailit datë 26.03.2024, është informuar nga ana e MBZHR-së⁶, si më poshtë vijon:

“Në lidhje me kërkesën tuaj dërguar me e-mail, nëse mund të përfitoni pagesën e vështirësisë në punë, ju sqarojmë se, duke ju referuar VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunëve në disa institucione të administratës publike”, ju nuk mund ta përfitoni pagesën e vështirësisë në punë.”

Bazuar në kërkimet e ankueses pranë KMD-së, vërehet se ka një paqartësi të aktit nënligjor të cilit duhet t'i referohet, pasi në citimin e VKM-së, për të cilin dhe ka ngritur pretendimet e saj, në formularin e ankesës citon VKM nr. 321, datë 31.05.2023, ndërsa në komunikimet me strukturat e MBZHR-së i referohet VKM nr. 325, datë 31.05.2023, dhe në e-mailin e datës 15.04.2024 drejtuar KMD-së, referon VKM nr. 326, datë 31.05.2023 .

⁶ Punonjësës Z. J të strukturave përkatëse të MBZHR-së.

Nga këqyrja e akteve nënligjore sipërcituar, rezulton se, ankuesja si pjesë e strukturave të QTTB-së Vlorë⁷ nuk përfshihet në fushën e veprimit të VKM-së nr. 321, datë 31.05.2023 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”, dhe as të VKM -së nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendëskryeministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”.

Akti rregullator nënligjor i cili përcakton shtesën për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, sikundër ankuesja ka pretenduar, është VKM nr. 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”.

Kjo VKM, ka përcaktuar në mënyrë të detajuar se:

“1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen punonjësit mbështetës dhe punonjës të tjerë të specialiteteve të ndryshme (në vijim punonjësit) në:

a) institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura, në nivel qendror e në administratën e prefektit;

b) institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura, në nivel rajonal/vendor.

2. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore të punonjësve, të përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, janë si më poshtë vijon:

a) Paga bazë për klasë;

b) Shtesa për vjetërsi në punë;

c) Shtesa për funksion drejtues;

c) Shtesa për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin;

d) Shtesa për natyrë të veçantë pune, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

...

6. Renditja e pozicioneve të punës për punonjësit e institucioneve, të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, është sipas krerëve II/1 deri në II/3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

...

9. Për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, punonjësve u jepet shtesë mbi pagë, sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë...

Ndarja e punëve, sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë, bëhet sipas lidhjes III, “Kriteret e ndarjes së punëve sipas shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10. Zbatimi i shtesës së përcaktuar në pikën 9, të këtij vendimi, sipas shkallëve përkatëse të vështirësisë e të dëmshmërisë bëhet, si më poshtë vijon:

a) Drejtoritë/njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucioneve të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, u paraqesin kërkesën e tyre drejtorive të shëndetit publik, të cilat

⁷ Në pozicionin e punës “Specialiste” në Sektorin e Menaxhimit të Resurseve dhe Shtimit të Materialit Mbjellës Bimor, në Drejtorinë e Teknologjive të Pemëtarisë, në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Vlorë, kategoria IV-a.

përcaktojnë vendet e punës, të vështira e të dëmshme për shëndetin e punëmarrësve, si dhe shkallën e vështirësisë e dëmshmërisë, për çdo vend pune;

b) Pas përcaktimit të shkallës së vështirësisë e dëmshmërisë, sipas shkronjës “a”, të kësaj pike, titullarët e institucioneve paraqesin kërkesën për miratim në ministrinë përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë dhe në ministrinë përgjegjëse për çështjet e punësimit;

c) Pas marrjes së miratimit nga dy ministritë e përmendura në shkronjën “b”, të kësaj pike, titullarët miratojnë dhënien e këtyre shtesave për punonjësit e institucioneve të sistemit të tyre. Për institucionet qendrore, në varësi të ministrave të linjës, si dhe ato rajonale e vendore, ky miratim bëhet nga ministri përkatës, në varësi të të cilit janë këto institucione;

ç) Kur punonjësit i takon të marrë dy a më shumë shtesa, sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë, ai do të marrë nga një shtesë vështirësie për çdo shkallë, por jo më shumë se 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj;

Lidhja III, “Kriteret e ndarjes së punëve sipas shkallës të vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin”

Në zbatim të pikës nr. 9, të këtij vendimi, punë që kryhen në kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, konsiderohen ato punë që kryhen në ambiente që kapërcejnë kufijtë e lejueshëm të faktorëve të dëmshëm për shëndetin, që përcaktohen në dispozita të veçanta ose në norma të detyrueshme higjienosanitare. Ndarja e punëve sipas shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin është si vijon:

1.Në shkallën e parë përfshihen punët që kryhen:

...

d) Në kushtet e ekspozimit ndaj rrezatimit ultraviolet ose infra të kuqe, për shembull saldimi, farkëtimi etj.;

2.Në shkallën e dytë përfshihen punët që kryhen:

...

b) Në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të substancave toksike që depërtojnë në organizëm; kjo do të njihet nga institucioni përgjegjës për higjienën dhe epidemiologjinë.”

Sa i takon pretendimit të ankueses se është diskriminuar nga ana e MBZHR-së, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

- Lidhur me pretendimin e ankueses për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, Komisioneri bazuar në arsyetimin e mëposhtëm, vëren se:

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e

pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këtë shkak.

Në këtë kontekst, Komisioneri për të vlerësuar nëse pretendimet e subjektit ankues për trajtim të pabarabartë e të pafavorshëm të tij nga ana e DPT-së, vijnë për shkakun e pretenduar, duhet që fillimisht ky shkak të jetë i provuar e dokumentuar para KMD-së, si shkak i njohur nga LMD.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim, Komisioneri vlerëson se, personi i cili pretendon se është diskriminuar për këtë shkak, por jo vetëm, duhet gjithashtu të parashtojë fakte nga të cilat mund të vlerësohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë një apo më shumë se një, nga shkaqet e mbrojtura, që në çështjen objekt shqyrtimi paraprak, është “çdo shkak tjetër”.

Sa i takon pretendimit të ankuesit për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvete.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë të hapur shkaqesh⁸. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh⁹.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar staturë të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “me

⁸ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë.....ose me çdo shkak tjetër.”

⁹ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

çdo shkak tjetër”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”.*

Komisioneri vëren se, “viktimat” e diskriminimit e kanë detyrimin të paraqesin fakte dhe prova nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim apo mbi bazën e të cilave të bëjnë të besueshëm pohimin se është bërë diskriminim. Pastaj, barra e provës i bartet të paditurit, i cili gjatë zhvillimit të procedurës hetimore duhet të dëshmojë se nuk ka pasur diskriminim, apo se ka pasur arsye ligjore për trajtim të pabarabartë.

Komisioneri vlerëson se, diskriminimi¹⁰ karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, duke elaboruar se më këtë shkak ankuesja nënkupton pozicionin dhe natyrën e veçantë të punës, ku ka të bëjë me element rrezikshmërie për shëndetin si: rrezatim ultravjollcë, substance të ndryshme kimike, etj, Komisioneri vlerëson se, ky pretendim nuk rezulton i provuar, pasi këtë konkluzion duhet ta nxjerrin organet përgjegjëse që, sipas VKM nr. 326, datë 31.05.2023, janë drejtoritë e shëndetit publik, të cilat përcaktojnë vendet e punës, të vështira e të dëmshme për shëndetin e punëmarrësve, si dhe shkallën e vështirësisë e dëmshmërisë, për secilin vend pune.

Vendimmarrja e Komisionerit duhet të jetë e arsyetuar dhe e argumentuar mbështetur në bazueshmërinë e provave e fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi pretendimet, faktet objekt verifikimi, gjykimi, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë.

Faktet që janë objekt i të provuarit merren për bazë për efekt provueshmërie, vetëm kur ato janë paraqitur me saktësi, në formën e kërkuar nga ligji dhe nga organi përgjegjës e kompetent për njohjen e lëshimin e tij. Pra, në kontekst të provueshmërisë së vetë shkakut të kërkuar, në kuptim të LMD-së, ky shkak nuk rezulton i dokumentuar apo i njohur e deklaruar nga organi kompetent për përcaktimin e vendit të punës së ankuseses, si vend pune i vështirë e i dëmshëm për shëndetin, duke vlerësuar dhe shkallën e vështirësisë e dëmshmërisë së tij.

Sa Komisioneri në bazë të rrethanave të shpjeguara nga subjekti ankues lidhur me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, gjykon se, nuk ka informacion të

¹⁰ “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes. Kjo pasi, ankuesja nuk ka arritur të provojë apo dokumentojë atë. Në mungesë të provave e fakteve mbi shkakun mbi të cilin supozohet se ka pasur diskriminim, pamundësohet vijimi i procedurës për shqyrtimin e ankesës.

Smë sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankueses për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, në kuptim të LMD-së, nuk rezulton i provuar dhe dokumentuar bazuar në provat e depozituara prej saj.

Në përfundim, për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja “b” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ...b) ... është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara në këtë Ligj, e për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj¹¹.

- *Lidhur me pretendimin e ankueses se përgjigja që i është kthyer nga MBZHR, nuk është shteruese dhe e plotë, Komisioneri vlerëson se, autoriteti mbikëqyrës i pavarur për zbatimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, është institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.*

Bazuar në nenin 24¹², të këtij Ligji, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shqyrton kërkesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në ligjin “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar.

Komisioneri, vëren se, çdo person, kur vlerëson se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ligji 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si Institucioni dhe organi kompetent i krijuar me ligj të posaçëm.

Ankimi bëhet në rastet kur subjekti juridik, institucioni:

- refuzon dhënien e informacionit;
- nuk përgjigjet;
- kthen përgjigje pa vënë në dispozicion dokumentin e kërkuar;
- kthen përgjigje të paplotë.

¹¹ Për analogji citojmë vendimet e KMD-së: Nr. 226, datë 06.11.2023, Nr. 41, datë 13.02.2024, Nr. 50, datë 20.02.2024, Nr. 84, datë 28.02.2024.

¹² “Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit. Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila, verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t’u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, Komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.....”.

Ankimimi pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda afateve ligjore të përcaktuara në këtë Ligj, dhe mosrespektimi i dispozitave të tij nga cildo subjekt juridik, sjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në nenin 18, të këtij Ligji.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përfundim të shqyrtimit të ankesës së subjektit ankues, vendos bazuar në dispozitat e Ligjit të posaçëm, për urdhërimin e autoritetit publik për të dhënë informacionin e kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme brenda një afati të caktuar. Në rast se autoriteti nuk jep sërish informacion, Komisioneri ka të drejtë të përcaktojë përgjegjësinë direkte dhe gjobën për titullarin e autoritetit publik, koordinatorin e të drejtës së informimit, apo çdo nëpunës të autoritetit, i cili ka penguar plotësimin e kërkesës tuaj. Kërkuesi ose autoriteti publik ka të drejtë ta ankimojë vendimin e Komisionerit në gjykatën administrative kompetente.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e këtij kërkimi të znj. Y, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj¹³.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues M. Y, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

¹³ Për analogji citojmë Vendimin nr. 194, datë 24.12.2019, Vendimin nr. 81, date 26.04.2022, të KMD-së.

